



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës  
01 Nr. 400-6648 /2016  
Dt. 03.02.2016

Bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institutit Edukativ – Arsimor dhe Aftësues dhe kërkesës së Drejtorisë së Arsimit nr.zytr.04/1575 e dt. 27.01.2016, me datë 03.02.2016, merrë:

### V E N D I M

1. Z. Hysen Brahimaj, nga fsh.Shqiponjë K. Gjakovë, i sistemuar në punët dhe detyrat e punëve Drejtor në Shkollën Fillore “ DËSHMORËT E KOMBIT “ në Shqiponjë i vazhdohet kontrata e punës Drejtor pranë të njëjtës shkollë edhe për një mandat, për periudhën kohore katër (4) vjeçare.
2. Të ardhurat personale për këtë vend pune ti llogariten sipas vlerës së koeficientit 7.8.

### A r s y e t i m

Z. Hysen Brahimaj, i sistemuar në punët dhe detyrat e punëve Drejtor pranë Shkollës Fillore “ DËSHMORËT E KOMBIT ” në Shqiponjë, pas vlerësimit të performancës së bërë nga Drejtoresha e Drejtorisë për Arsim znj. Diana Qarkaxhija dhe rezultateve të punës të mira në aktivitetin profesional dhe në aktivitete tjera në fushën e edukimit dhe të ngritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, u rekomandua që ti vazhdohet kontrata e punës Drejtor pranë të njëjtës shkollë edhe për një mandat për periudhën kohore katër (4) vjeçare.

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë për Arsim si dhe dispozitave ligjore të parapara me Udhëzimin Administrativ Nr.08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institutit Edukativ – Arsimor dhe Aftësues, z. Hysen Brahimaj, i vazhdohet kontrata e punës Drejtor në Shkollën Fillore “ DËSHMORËT E KOMBIT “ në Shqiponjë K. Gjakovë, në periudhën kohore katër (4) vjeçare dhe atë nga data 01.02.2016 e deri me 31.01.2020.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë aktvendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

**Vendimi iu dorëzohet:** Kryetares së Komunës, z. Hysen Brahimaj, Drejtorisë për Arsim, Udhëheqësit të Personelit, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit.

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari - Lila

